

# IDENTIFIKIMI I QENVE ME MIKROÇIP DHE REGJISTRIMI





• **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**, në mars të vitit 2021 ka aprovuar ndryshimet e **Udhëzimit Administrativ (UA)** për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese. Me ndryshimet e reja, është obligim ligjor për çdo pronar të kafshës shoqëruese (qen, mace) ta bëjë identifikimin dhe regjistrimin e kafshës së tij/saj.

• **Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë**, si institucion që zhvillon dhe zbaton politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me qëllim të zbatimit të këtij UA, ka kontraktuar subjektet veterinarë për të ofruar shërbimin e identifikimit dhe regjistrimit të qenve me pronar **FALAS për një (1) vit**.



## SI BËHET IDENTIFIKIMI DHE REGJISTRIMI?

Për ta identifikuar dhe regjistruar qenin tuaj, duhet ta dërgoni te veterinari. Pasi të dërgohet te veterinari, **qenit i vendoset një mikroçip në trup, i cili ndërlidhet me të dhënat e pronarit**, të cilat ruhen në Regjistrin Qendror të Kafshëve, i cili menaxhohet nga AUV.

• **Përmes mikroçipit & regjistrimit**, në rast të humbjes së kafshës, pas skanimit të mikroçipit, mund të bëhet **ribashkimi i kafshës me pronarin**.

• Pas vendosjes së mikroçipit, kafsha do të pajiset me pasaportën zyrtare të Republikës së Kosovës për kafshët shoqëruese, të aprovuar nga AUV.



PASAPORTA PËR KAFSHËT SHOQËRUESE



## ŠKA ĖSHTË MIKROÇIPI DHE SI VENDOSËT?

**Mikroçipi** është pajisje elektronike me përmasa shumë të vogla, i cili **vendoset nën lëkurën e kafshës**. Mikroçipi përmban një numër unik identifikues, i cili mund të lexohet përmes lexuesve/skanerëve digjital.

Procedura e vendosjes së mikroçipit është shumë e thjeshtë dhe aspak e dhimbshme për kafshën. **Mikroçipi injektohet përmes gjilpërës** nën lëkurën e kafshës, ashtu si vaksinat, dhe nuk ka nevojë për përdorim të anestetikëve për t'u aplikuar.

**VINI RE:** Vetëm mikroçipat me kod të Republikës së Kosovës si pjesë e numrit unik identifikues janë të vlefshëm dhe po ashtu vetëm librazat/pasaportat e lëshuara nga AUV janë të vlefshme.



## SI BËHET NDĚRLIDHJA E MIKROÇIPI T ME PRONARIN E KAFSHĚS?

**Numri unik identifikues i mikroçipit** ndërlidhet me të dhënat e pronarit të kafshës, të cilat ruhen në **Regjistrin Qendror të Kafshëve**, i cili menaxhohet nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë. Të dhënat personale, trajtohen dhe ruhen sipas dispozitave ligjore në fuqi për mbrojtjen e këtyre të dhënave.



## CILAT TĚ DHĚNA RUHEN NĚ REGJISTRIN QENDROR TĚ AUV-SĚ?

### 1. TĚ DHĚNAT E PRONARIT TĚ KAFSHĚS

- Emri dhe Mbiemri
- Nr. personal
- Adresa dhe nr. i telefonit

### 2. TĚ DHĚNAT E KAFSHĚS SHOQËRUESE

- Numri unik identifikues i mikroçipit
- Moshë
- Gjinia
- Historiku shëndetësor
- Historiku i vaksinave



## NUK ĖSHTË GPS

**Mikroçipi nuk mund të gjurmtojë lokacionin e kafshës.** Mikroçipi shërben vetëm si mjet identifikues për ta lidhur kafshën me pronarin dhe për ta mbrojtur mirëqenien e qenve duke ndihmuar për rikthimin e kafshëve të humbura në shtëpitë e tyre.

**VINI RE:** Regjistrimi i qenve është obligim ligjor. Mosregjistrimi i qenve është i dënueshëm me gjobë sipas ligjeve në fuqi.



## KASTRIMI DHE STERILIZIMI FALAS

Përveç identifikimit dhe regjistrimit, AUV ofron falas edhe kastrimin/sterilizimin e qenve, për të gjithë pronarët e interesuar të marrin këtë shërbim por nuk është obligative. Kastrimi te qentë meshkuj dhe sterilizimi te qentë femra nënkupton heqjen e organeve riprodhuese, për të ndaluar mundësinë për shumim.

Përveç shumë përfitimeve shëndetësore për qentë, **kastrimi/sterilizimi parandalon edhe lindjet e padëshiruara dhe pa planifikuara të këlyshëve, duke parandaluar braktisjen e tyre në rrugë dhe rritjen e numrit të qenve endacak.**





## PËRFITIMET E KASTRIMIT I STERILIZIMIT

Pas sterilizimit, qentë femra do të jetojnë jetë më të gjatë dhe më të shëndetshme. Sterilizimi parandalon infeksionet e mitrës dhe ul mundësinë e shfaqjes së tumoreve të gjirit. **Sterilizimi i qenve para afshit të parë** ofron mbrojtjen më të mirë nga këto sëmundje. Kastrimi i qenit mashkull parandalon kancerin e testikujve dhe disa probleme të prostatës.

**Përmirësim në sjellje të qenve:** Qentë e kastruar/sterilizuar do të kenë **më pak gjasa të bredhin** dhe të ikin nga shtëpia për t'u çiftuar me qen të tjerë në rrugë apo në lagje. Largimi i qenve nga shtëpia mund të rrezikojë mirëqenien e tyre sepse mund të lëndohen në trafik apo të përfundojnë në përlëshje me kafshë të tjera.



## PROCEDURA E IDENTIFIKIMIT & REGJISTRIMIT

### HAPTI 1:

Kontakto veterinarin nga ueb-faqja e AUV-së (<https://auvk.rks-gov.net>)

Nëse jetoni në periferi, jeni fermer apo keni numër të madh të qenve, mund ta kontaktoni veterinarin që identifikimi & regjistrimi dhe vaksinimi, të bëhet në shtëpinë tuaj apo në pikën më të afërt për ju, në marrëveshje me veterinarin.

### HAPTI 2:

Qeni identifikohet me mikroçip nga veterinari dhe numri unik i mikroçipit, së bashku me të dhënat e mbajtësit/pronarit, regjistrohen nga veterinari, në Regjistrin Qendror të Kafshëve pranë Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV). Qeni po ashtu vaksinohet me vaksinë kundër tërbimit.

### HAPTI 3:

Nëse dëshironi, mund të kastroni apo sterilizoni qenin tuaj **FALAS** për të parandaluar sëmundje të ndryshme dhe lindje të padëshiruara të këlyshëve.

- Nëse vendosni të dhuroni apo të shitni qenin tuaj te ndonjë mbajtës/pronar tjetër - në rast se nuk mund ta mbani më - lajmërohuni tek veterinari që të bëhet ndërrimi i pronarit të qenit në regjistrin qendror të AUV-së.
- Në rast se vini nga ndonjë shtet tjetër për të jetuar në Kosovë për më shumë se tre (3) muaj, duhet ta regjistroni qenin me të dhënat tuaja pranë veterinarit. Nëse vendosni të mos jetoni më në Kosovë me qenin tuaj, duhet ta lajmëroni veterinarin apo direkt AUV-në.
- Në rast të vdekjes së kafshës, duhet ta lajmëroni veterinarin për ta regjistruar vdekjes e kafshës së regjistruar në Regjistrin Qendror të kafshëve.

**MBANI QENTË ME PËRGJEGJËSI DHE MOS I BRAKTISNI!**

Për më shumë informata vizito: <https://auvk.rks-gov.net>



Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve  
Animal Rights Foundation  
Fondacija za prava životinja